



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E RREGULLIMIT EKONOMIK

Nr. 2963/1 prot.

Tiranë, më 3.12.2025

VENDIM

Nr. 55 Datë 3.12.2025

**PËR PEZULLIMIN E LICENCËS SË OPERIMIT SHOQËRISË AJRORE AIR
ALBANIA SH.P.K**

Bazuar në pikën 2/c, neni 21 të Ligjit nr.96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, Ligjit nr.53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil” “, pikës 5, neni 10 të Vendimit nr. 802, datë 28.12.2023 “Për miratimin e kërkesave për dhënien e licencës së operimit për ofrimin e shërbimeve ajrore, procedurat, kriteret dhe kushtet për refuzimin, pezullimin apo revokimin e licencës së operimit”, si dhe të Vendimit të Drejtorit Ekzekutiv Nr. 45, datë 17.11.2025 “ Për pezullimin e Certifikatës së Operatorit Ajror “Air Albania sh.p.k”, si dhe Vendimit Nr.46, datë 18.11.2025 “Për shtesa dhe ndryshime në Vendimin Nr.45, datë 17.11.2025 “Për pezullimin e Certifikatës së Operatorit Ajror Air Albania Shpk”,

VENDOSA:

1. Pezullimin e Licencës së Operimit të operatorit ajror shqiptar Air Albania sh.p.k Nr. AL-002, datë 16.4.2019 për shkak të pezullimit të Certifikatës së Operatorit Ajror.
2. Njoftimin e operatorit ajror Air Albania sh.p.k mbi këtë pezullim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

